



## NE VEND TE EDITORIALIT

**Dr. Albana Rexhepaj  
Roland Leli**

Viti Ndërkombëtar i Fizikës 2005 është një festim botëror për këtë shkencë të natyrës si dhe vlerësim dhe shprehje e rëndësisë së saj në jetën tonë të përditshme. Ajo në fakt nuk luan vetëm një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkencave të tjera dhe teknologjisë por ka edhe një ndikim të madh mbi shoqërinë tonë nëpërmjet zbatimeve praktike të panumërta. Ky përkujtim i fizikës përpiqet të rrisë ndërgjegjen botërore e të afrojë publikun e gjerë me këtë shkencë të saktë e arritjet e saj.


Kësaj teme ne i kemi dedikuar rubrikën e re “Dossier” në Buletinin tonë të qershorit. Do të jetë kjo një rubrikë e përhershme në faqet e Buletinit që do të përmbledhë biografi të fizikanëve të shquar në shekuj, shkime shkencore mbi teoritë e ndryshme dhe konceptet kryesore të fizikës, grimca shkencore e të rejat e fundit në lidhje me këtë fushë të gjerë e të rëndësishme studimi.

Një rubrikë tjetër e re që kemi vendosur të publikojmë tani e tutje është edhe ajo e intervistës sonë me një nga anëtarët e Alb-Shkencës. Kësaj radhe kemi intervistuar studiuesin fizikan Kujtim Latifi (koincidencë e kënaqshme me Vitin e Fizikës) që aktualisht kryen punën e tij në Argonne National Laboratory pranë Chicago-s (ShBA). Pasi iu përgjigjet pyetjeve tona, Kujtimi bën edhe një përshkrim interesant të këtij laboratorit të famshëm kërkimor-shkencor dhe të projekteve aktuale që janë në zbatim e sipër.

Në kuadrin e kryerjes së zgjedhjeve të përgjithshme në Shqipëri në faqet e para të Buletinit kemi sjellë shkrimin-analizë të Dr. Ardian Harrit dhe Dr. Albana Rexhepajt me titull: “Çfarë kërkojnë qytetarët e thjeshtë nga klasa politike aktuale?”. Në këtë shkrim autorët vihen në petkun e njerëzve të thjeshtë të cilët pasi ia japin votën politikanit

apo partisë së zezës kërkojnë edhe të drejtat e tyre legjitime që tu plotësohen një ditë.

“Predikimi i Krishtëritimit ndër ilirët, të parët e shqiptarëve” është pjesë e një studimi voluminoz që Dr. Thanas Gjika sjell në Alb-Shkencë që të lexohet e të diskutohet me frymë kritike për përmirësime të mëtejshme. Shkrimi ka një bibliografi shoqëruese e më pas ndiqet nga një analizë kritike paragraf për paragraf që Ardian Vehbiu bën për të mbështetur pikëpamjet e tij për argumentin në fjalë.



“Portret shkencëtari” është edhe kjo rubrikë e re për të sjellë çdo herë pranë lexuesve të Buletinit tonë një shkencëtar të nderuar, shqiptar apo të huaj, të kohëve të kaluara apo bashkëkohor, i cili ka lënë gjurmë me kontributin e tij. Këtë herë kemi zgjedhur biologun e shquar të kohëve tona, ish president i Akademisë Kombëtare Amerikane të Shkencave, Bruce Alberts.

Më tej do të gjeni recensionin e hollësishëm të Prof. Alfred Uçit mbi monografinë e Zymer Ujkan Nezirit me titull “Poetika e krahasimit” i botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në vitin 2004.

Në mbyllje të Buletinit kemi botuar listën e papëve me origjinë iliro-arbëreshe dhe kontributin e tyre dhënë Kishës katolike, të përpiluar nga Gjin Andrea Varfi.

Ju urojmë të gjithëve një lexim të këndshëm e mirëpresim gjithmonë ndihmën, sugjerimet, kërkesat dhe kritikën tuaj konstruktive që të kemi një organ interesant, të vlefshëm e të denjë për të gjithë antarët dhe lexuesit e Alb-Shkencës kudo që punojnë e studiojnë.

## ÇFARE KERKOJNE QYTETARET E THJESHTE SHQIPTARE NGA KLASA POLITIKE AKTUALE?

Dr. Ardian Harri (ShBA)  
Dr. Albana Rexhepaj (Zvicër)

Fushatat parazgjedhore janë një ngjarje e rëndësishme në jetën e një vendi dhe atë të qytetarit. Për vendin, çdo situatë parazgjedhore është një mundësi për t'u ballafaquar me të kaluarën por dhe një mundësi për rishikim e riformulim të së ardhmes. Për qytetarin fushatat parazgjedhore japin mundësinë e ballafaqimit të drejtëpërdrejtë me politikanët të cilëve ju patën besuar plotësimin e interesave të tyre, drejtimin e jetës së komunitetit dhe në të njëjtën kohë, mundësinë që të diskutojnë në mënyrë intensive me vetveten, me fqinjën por edhe me politikanët-pozitarë të së nesërme, për nevojat e jetës së tyre të përditshme dhe ëndërrat e së ardhmes.

Nevojat e përditshme të qytetarit, ndërtimi i infrastrukturës që mundëson një jetë me dinjitet sot dhe nesër janë dhe duhet të jenë boshti i një fushate parazgjedhore. Vetëm se një vështrim në këtë fushatë parazgjedhore tregon se dominante në të është jo qytetari dhe nevojat e tij por vetë klasa politike. Shpërdorim pushteti, korrupsion dhe premtime të parealizuara, mungesa e prurjeve të reja politike, e njerëzve të rinj të politikës, trukime imazhi me "hapje", "kthime", "bashkime", ripërsëritje premtimesh që më shumë i flasin kundërshtarit politik se sa qytetarit. Pas 15 vitesh pluralizmi, klasa politike shqiptare ndodhet në një deflacion besueshmërie që është pasojë e humbjes së interesit të saj në nevojat e punëdhënësit dhe paguesit të saj: qytetari!

Realiteti i periudhës së tranzicionit provon se qeveria shqiptare efektivisht ka hequr dorë pothuajse plotësisht nga disa përgjegjësi e kontrole që, edhe pse ofrojnë vetëm plotësimin minimal të kërkesave të qytetarëve, ato krijojnë ndjenjën e një farë sigurie. Shembuj të këtyre përgjegjësive janë shkollimi, punësimi, strehimi etj. Gjatë kësaj periudhe tranzicioni qytetarët shqiptarë janë lënë që t'i plotësojnë vetë këto kërkesa të tyre. Sigurisht, kushdo që ka jetuar e provuar jetën në ekonominë e zhvilluara të tregut do të thoshte se, qytetarët janë vetë përgjegjës për shkollimin, punësimin, strehimin e tyre: ky është një tipar i ekonomisë së tregut. Kjo është plotësisht e vërtetë. Por, përtej përgjegjësisë individuale, ato që klasa politike nuk i ka krijuar ende qytetarit shqiptar janë një terren dhe kushte të tilla që mundësojnë secilin në mënyrë të barabartë të përpiqet për t'i plo-

tësuar këto kërkesa. Prandaj, janë pikërisht këto kushte që qytetarët shqiptarë kërkojnë, në rradhë të parë, të krijojnë klasa politike:

1. Të drejtën e pronësisë private – e shprehur kjo më dukshëm në rastin e pronësisë mbi tokën (truall apo bujqësore). Për pronësinë mbi tokën dhe lidhur me të dhe tregun e shitblerjes për tokën, veçanërisht të interesuar janë fermerët shqiptarë që duan të zhvillojnë biznesin e tyre bujqësor. Kjo do të bëjë të mundur edhe plotësimin e kërkesës së familjeve shqiptare për kthimin e fëmijëve të tyre që punojnë, fatkeqësisht, si "skllëvër modernë" nëpër fushat e vendeve fqinjë, për të punuar për veten e tyre në shtëpinë e tyre. Përveç kthimit të tyre, kjo do të mundësojë edhe investimin në biznesin e tyre të njohurive apo kapitalit të fituar. Për pronësinë mbi tokën e truallin janë të interesuar edhe pronarët e tokave në zonat bregdetare apo edhe malore, të cilët synojnë zhvillimin e mjediseve turistike bregdetare e malore. Për pronësinë mbi tokën/truallin janë të interesuar po ashtu të gjithë ata qytetarë që synojnë investime afatgjata dhe të rëndësishme mbi pronat e tyre, investime të cilat deri më sot mungojnë pothuajse plotësisht për vetë shkallën jo të vogël të rrezikut që përfaqësojnë.

2. Të drejtën e pronësisë mbi pasuritë kombëtare të privatizuara që nga 1990 apo që do të privatizohen në të ardhmen e afërt apo të mesme. Që nga 1990, qytetarët e thjeshtë shqiptarë nuk kanë përfituar asgjë nga privatizimet e pasurisë kombëtare (me përjashtim të atyre që përfituan apartamentet ku jetonin). Klasa politike e ka privatizuar pasurinë e përbashkët kombëtare për shumë më pak se vlera e saj reale, është bërë pronare private e saj duke e përjashtuar qytetarin shqiptar nga e drejta e pronësisë mbi pasurinë e përbashkët kombëtare dhe i ka keqadministruar edhe ato pak të ardhura të vjelura nga privatizimet. Është shumë e rëndësishme që pronarë të pasurisë kombëtare të bëhen apo mbeten shqiptarët, por është e rëndësishme që pronar i kësaj pasurie kombëtare të bëhet çdo shqiptar dhe jo vetëm një pakicë.

3. Të drejtën e përfshirjes në aktivitetin ekonomik për të krijuar, investuar e shtuar kapitalin monetar dhe atë njerëzor. Qytetarët shqiptarë me shpirt sipërmarrës, ata të konfirmuar si të suksesshëm apo ata që nuk kanë mundur të bëjnë ende realitet idetë e tyre, brenda apo jashtë Shqipërisë, kërkojnë që klasa politike të heqë monopolin ekzistues të liçensimit vetëm për antarët e saj dhe të afërmit e tyre. Ata kërkojnë heqjen e pengesave

burokratike apo trajtim të barabartë nga organet tatimore – me pak fjalë një mundësi të barabartë për një konkurrencë të ndershme.

Kërkesat e mësipërme janë thelbësore. Ato do të krijojnë për qytetarin shqiptar atë që ende mungon, një terren të hapur e pa kufizime, me mundësi më të mëdha për të plotësuar nevojat e tij dhe të familjes së tij. Me fjalë të tjera, këto kërkesa do t'i jepnin qytetarit shqiptar ato që ai i ka parë të ekzistojnë si norma në vendet e ekonomisë së tregut – lirinë dhe mundësinë e zgjedhjes dhe të vendimit se si ta organizojë jetën e tij, se si t'i plotësojë nevojat dhe dëshirat e tij apo familjes së tij. Tani që qytetari shqiptar është i pajisur me mundësinë për t'iu përgjigjur vetë disa kërkesave jetësore, kërkesat e tij ndaj klasës politike vijojnë si më poshtë:

a) Investime shtetërore në infrastrukturën rrugore, energjetike etj. për të lehtësuar zhvillimin e nismave private në tregti, bujqësi, turizëm dhe çdo sektor tjetër të ekonomisë në përgjithësi.

b) Investime shtetërore në arsim. Këtë e kërkojnë fëmijët e vegjël (dhe prindërit e tyre) që ecin me orë të tëra për të shkuar në shkollë. Këtë e kërkojnë ata fëmijë që kanë hequr dorë nga shkolla

për të fituar bukën e gojës. Këtë e kërkojnë edhe studentët të cilët me të drejtë dëshirojnë që diplomat e tyre të kenë kuptim e vlerë.

c) Investime shtetërore në shëndetsi. Këtë e kërkojnë ... të gjithë qytetarët shqiptarë.

d) Jo më pak e rëndësishme se kërkesat e mësipërme është edhe ajo ndaj klasës politike dhe shtetit që kjo klasë udhëheq, për mbrojtjen dhe garantimin e jetës së tij dhe familjes së tij, mbrojtjen dhe garantimin e pronës apo veprimtarisë së tij. Këtë e kërkojnë prindërit e atyre që nisen pa e ditur mirë se ku venë në kërkim të një jete më të mirë por që shpesh humbin dhe atë që kanë. Këtë e kërkojnë prindërit e fëmijëve të trafikuar, rrëmbyer, vrapë, rrahur kërcënuar. Këtë e kërkojnë familjet e biznesmenëve të vrapë apo të rrëmbyer. Këtë e kërkojnë edhe qytetarët shqiptarë të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Vlorës, Fierit etj. jeta e të cilëve është seriozisht e rrezikuar nga ndotja e mjedisit.

e) Së fundi, një kërkesë e qytetarit shqiptar për klasën politike, e pashkruar por e nënkuptuar nga sa më lart, është ajo për më shumë patriotizëm dhe ndershmëri. Një kërkesë fare e thjeshtë por që klasa politike është kaq e vonuar në realizimin e saj.

**FAKTE KRAHASUESE MIDIS REGJIMEVE  
PRESIDENCIALE DHE ATYRE PARALAMENTARE  
SI DHE SISTEMEVE MAZHORITARE  
APO PROPORCIONALE TE ZGJEDHJEVE**

Regjimet presidenciale çojnë në krijimin e qeverive më të vogla në krahasim me demokracitë parlamentare. Ata po ashtu ulin shpenzimet qeveritare me rreth 5% të PBB-së (Produhimi i Brendshëm Bruto) në krahasim me demokracitë parlamentare.

Sistemet mazhoritare të zgjedhjeve çojnë në krijimin e qeverive më të vogla dhe programeve të ndihmës sociale (welfare) më të pakta se sistemet proporcionale.

Kalimi nga një sistem proporcional në atë mazhoritar ul shpenzimet qeveritare me rreth 5% të Pbb-së dhe shpenzimet për ndihmë sociale me rreth 2% të Pbb-së.

Për te interesuarit referenca e plotë:

Persson T., and G. Tabellini. *Constitutional Rules and Fiscal Policy Outcomes*. The American Economic Review, March 2004, 94(1), pp. 25-45.

Ardian Harri

**KRONOLOGJI**

Ditët e fundit u nda nga jeta Dr. BAREND A.J. COHEN, mjek i nderuar ligjor dhe aktivist i nderuar i të drejtave të njeriut.

Dr Cohen e vizitoi Kosovën para dhe pas krizës së vitit 1999 për të konstatuar shkeljet e kryera gjatë spastrimit etnik dhe gjenocidit kundër popullsisë shqiptare. Ai nguli këmbë me vendosmëri për korrigjimin dhe kërkimin e ndjesës nga gazeta e njohur amerikane *New York Times* për një artikull të saj ku kosovarët e mesit të viteve 1990 ishin prezantuar jo këndshëm. Në këtë kohë ai u nderua me titullin "Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë".

I njohur midis miqve shqiptarë si Bardhi, Dr Cohen ishte një pjesëmarrës aktiv në shumë projekte anembanë botës për të ndihmuar popullsitë e vendeve të vuajtur: Uganda, Ballkan, Lindje e Mesme, Indonezi ku ai lindi më 1942 etj.

Gjatë jetës së tij ai mori shumë çmime akademike e profesionalëve përfshi edhe Royal Order of Oranj Nassau dhënë nga mbretëresha e Hollandës. I udhëhequr nga objektiviteti i thellë, në avokatinë e të drejtave të njeriut dhe gjithmonë në krahu të viktimave ai do ju mungojë familjes kolegëve e miqve në të katër anët e botës përfshi këtu edhe shumë shqiptarë.

At Arthur E. Liolin

## PREDIKIMI I KRISHTERIMIT NDER ILIRET, TE PARET E SHQIPTAREVE

Dr. Thanas Gjika

*Të dashur lexues vitin e kaluar z. Ardian Vehbiu përsëriti një hipotezë të përhapur, por për mua të gabuar, sipas së cilës të parët tanë ilirët e kanë marrë Krishterimin prej Romës në latinisht. Unë u nxita prej kësaj hipoteze dhe gjatë ripunimit të studimit tim Kur dhe ku janë shkruar librat e Dhjatës së re u përpoqa t'i jap zgjidhjen time. Para se ta botoj dua që këtë pjesë ta diskutoj në Alb-Shkencë ku ka gjuhëtarë të kualifikuar si z. Vehbiu, teologë të mirëformuar si at Foti Cici dhe shumë intelektualë të dalluar për kulturë të gjerë dhe mprehtësi logjike. Pres pra me kënaqësi kritikën e sugjerimet tuaja. Faleminderit.*

Ideja që sundon sot se Krishtërimin ilirëve, paraardësve të shqiptarëve ua shpunë misionarët fetarë prej Romës, nuk është e vërtetë. Historiani amerikan Edwin E. Jacques dhe ai shqiptar Kristo Frashëri<sup>1</sup> kanë provuar para nesh se Krishtërimin banorëve ilirë të territoreve ku jetojnë sot shqiptarët ua shpunë apostulli Pal me nxënësit e tij në vitet 50-60-të të shek I e. r., në po atë kohë kur ata ua shpunë galatëve, frigasve e thrakëve në Azinë e Vogël dhe maqedonëve e grekëve në Ballkan.

Pas argumentimin historik, i cili shpie përpara punën e historianëve Daniel Farlati, F. Konica, E. Jacques, K. Frashëri, po përpiqem të jap dhe një argumentim gjuhësor.

Hipoteza, sipas së cilës Krishtërimi është përhapur në ilirët e jugut prej Romës, ka gjetur dhe një përkrahje gjuhësore. Gjuhëtarë të shquar gjermanë gjatë shek XIX-të dhe etimologë me emër si shqiptarët Egerem Çabej<sup>2</sup> e Idriz Ajeti, dhe latinisti i njohur francez Guillaume Bonnet<sup>3</sup> etj. kanë mbrojtur idenë se shumë fjalë që i përkasin Krishtërimin të hershëm si "kryq", "shenj", "kumbonë" (këmborë), "pagëz", "pagëzim" etj; ilirishtja i ka marrë prej latinishtes përmes predikimeve të misionarëve të krishterë të vajtur prej Romës. Mirëpo një vështrim më i thelluar në historinë e formimit të ilirishtes dhe latinishtes shpie në kokluzionin se këto fjalë i ka pasur ilirishtja disa shekuj përpara se të formohej Perandoria Romake, kohë kur latinishtja filloi të ushtronte një rol dhënës ndaj ilirishtes.

Sipas studiuesit francez Robert D'Angely, popullsia që banonte gjithë brigjet e Mesdheut para formimit të gjuhës e të kulturës helene ishte e njëjtë, ndonëse kishte emra të ndryshëm fisnorë. Kjo

popullsia, sipas tij, e ruajti gjuhën e vet edhe mbas krijimit të kulturës e të gjuhës helene e të asaj latine, deri në kohën e Perandorisë Bizantine<sup>4</sup>.

Sipas studiuesve të sotëm, popullsia indoeuropiane erdhi në Europë 7000-10.000 vjet më parë duke mbushur së pari gadishullin Ballkanik, pastaj gadishullin Italik e më pas Francën dhe gadishullin Hiberik. Kjo popullsia e njëjtë krijoi dhe një unitet gjuhësor në brigjet e Mesdheut, i cili deri në shek. I të e. r. duhet të jetë ruajtur me disa ndryshime dialektore, të cilat D'Angely nuk i ka pranuar. Afërsia e madhe e shumë fjalëve të fondit themelor në gjuhën e sotme shqipe, në rumanisht, frëngjisht e spanjisht dhe në gjuhët nëna të tyre si ilirishtja, dakishtja, galishtja e keltishtja nuk duhen konsideruar thjesht latinizma, si konsiderohen sot, por fjalë të trashëguara nga dialektet e gjuhës nënë, e gjuhës barbare, të cilën e fliste popullsia e përbashkët indoeuropiane e këtyre trojeve.

Po jap më poshtë shpjegimin tim për disa fjalë të fondit kishtar të gjuhës shqipe:

Fjala "kryq", në gjuhën shqipe, sipas meje, është një fjalë e trashëguar prej dialektit ilir të gjuhës barbare të përbashkët dhe nuk e ka origjinën nga fjala latine *crux*, si mendon gjuhëtari francez G. Bonnet<sup>5</sup>. Fjala "kryq" dhe kompozitat e saj "duarkryq", "këmbëkryq", "udhëkryq" etj. bashkë me fjalën "kryqet" (që nuk ka lidhje me fjalën latine *lumbaris*) si dhe shprehjet "më ranë kryqet", "ngre kryqet" etj. mendoj se kanë ekzistuar në ilirisht shumë shekuj, për të mos thënë mijëra vjet, para lindjes së Krishtërimin. Për lashtësinë pararomake të fjalës "kryq" flet si përdorimi i saj për të emëruar pjesë të trupit njerëzor ose pozicione të gjymtyrëve dhe përdorimi i kryqit si objekt për të simbolizuar riprodhimin, simbol të cilin e respektonte popullsia e lashtë e Ballkanit, para Krishtërimin.

Fjalët "kumbonë" dhe "këmborë", mendoj se kanë një origjinë thjesht ilire dhe jo prej fjalës latine *campana*<sup>6</sup>. Fjala "kumbonë" vjen nga folja "kumbon", e cila ka një origjinë të padiskutueshme onomatopoeike. Ajo është krijuar me brumin e ilirishtes nga imitimi i zhurmës që krijon rënia e kumbonës: kumb, kuummb. Folja "kumbon" e shqipes (ilirishtes) është shumë larg, për të mos thënë e pakrahasueshme, me foljen latine *campanire*.

Ekzistenca e këtyre fjalëve në ilirishten e kohës pararomake nuk ka pse të mohohet, sepse orakujt e ilirëve gjatë ushtrimit të fesë së lashtë politeiste përdornin "kumbonat" për të mbledhur popullin

për ceremonitë e ndryshme fetare. Ndëkohë dihet se ilirët kanë qenë blegtorë të mirë. Barinjtë ilirë i kishin varur në qafët e bagëtive kumbonat e vogla (këmborët) mijëra vjet para pushtimit romak.

Fjala “pagëzoi” konsiderohet me origjinë nga fjala latine *baptizare*, pasi ka pësuar deformime të mëdha<sup>7</sup>. Mirëpo prania e fjalës ilire (shqipe) “gëzoi” në përbërje të kësaj fjale dhe ndërtimi i fjalëve të tjera që lidhen me të, si “pagëzim”, “i pagëzuar”, “pagëzor” etj. jo sipas formave korresponduese të latinishtes na shtyn të dyshojmë për origjinën latine të kësaj fjale. Unë supozoj se prejardhja e fjalëve “pagëzoi”, “pagëzim” etj. duhen kërkuar në togfjalshat “gëzim i parë”, “po gëzojmë së pari”. Vënia e emrit disa ditë pas lindjes ka qenë ceremonia e gëzimit të parë për jetën e një fëmije shumë kohë përpara se kjo ceremoni të kthehej në një festë fetare të Krishtëritimit. Përdorimi i dendur i togfjalshit “gëzim i parë” ka çuar në krijimin e kompozitave “parëgëzim”, “parëgëzoi” të cilat me kohë janë reduktuar në “pagëzim” e “pagëzoi”.

Fjalët “shenjt/i shenjtë”, bashkë me fjalët “shenjë, shënoj”, të cilat bëjnë pjesë në një çerdhe kuptimore dhe etimologjike, duhen parë si fjalë të vetë ilirishtes sepse në latinisht nuk i përkasin së njëjtës çerdhe. Fjala latine *sanctus* (i shenjtë) nuk ka lidhje kuptimore dhe as etimologjike me fjalën “signum” (shenjë). Kështu fjalët “shenjt, njeri i shenjtë” që lidhen kuptimisht me fjalën “shenjë” dhe që kanë pasur kuptimin fillestar parakristian “njeri me shenjë, njeri i shënuar”, në gjuhën shqipe, pasardhësen e ilirishtes, duhet të shihen si origjinale dhe jo si latinizma.

Fjala “shpirt” (Shpirti i shenjtë) është futur në ilirisht prej latinishtes kishtare *spiritus* (Spiritus sanctus), por ilirishtja dhe shqipja për këtë fjalë ka pasur dhe ka fjalën e vet të vjetër “frymë” (Fryma e shenjtë). Fjala “frymë” vjen nga folja “fryj”, e cila ka origjinë onomatopeike, sepse është krijuar nga imitimi i veprimtimit të fryrjes së zjarrit ose imitimi i zhurmës së erës. Kështuqë kjo fjalë, si ka shpjeguar Çabej ka origjinë thjesht ilire (shqipe)<sup>8</sup>.

Fjalët “i krishter/Krishtëritim” janë fjalë të krijuara prej fjalës greke *Hristos* dhe prapashtesave të gjuhës ilire dhe jo të huazuara prej fjalëve latine *christianus/Christianismus*. Këto forma kanë filluar të përdoren vonë në shqip “kristian/, Kristianizëm”, natyrisht jo si huazime latine po si huazime nga gjuhët e sotme europiane.

Origjina ilire e fjalëve kishtare të lartpërmendura bashkë me fjalë e togfjalsha të tjerë të kësaj fushe si “lind”, “lindja e Krishtit”, “ngjallje”, “ringjallja e Krishtit”, etj. tregon se roli dhënës i latinishtes

në këtë sferë të gjuhë ilire (shqipe) është mbivlerësuar.

Prania e fjalëve ilire (shqipe) në sferën e terminologjisë kishtare, bashkë me praninë e greqizimeve si “kishë, Krisht, peshkop, ajazmë” etj. dëshmon për faktin se predikimi i fesë së re, i fesë së krishterë, midis ilirëve është kryer në gjuhën greke me përkthim në gjuhën vendase dhe jo në latinisht. Në rast se kjo fe e re do t’u ishte predikuar ilirëve vetëm prej emisarëve të kishës së Romës në latinisht, greqizmat që hasen edhe sot nuk do të kishin pasur arsye pse të hynin e mbijetonin në shqipen, pasardhësen e ilirishtes. Kurse prania e fjalëve ilire, krahas greqizimeve, në sferën e gjuhës kishtare shqipe dëshmon për predikimin e fesë së re midis ilirëve në greqisht me përkthim në ilirisht që në kohën apostolike.

Si përfundim: Predikimet e fesë së krishterë në latinisht midis ilirëve kanë filluar vetëm nga shekulli i IV-t, kur perandori Kostandin i Madh e shpalli Krishtëritimin fe zyrtare. Përdorimi i predikimeve në latinisht gjatë shekujve IV-XX-të midis ilirëve e më vonë shqiptarëve, solli si pasojë futjen e disa fjalëve latine në gjuhën ilire (e shqipe) kishtare ndoshta dhe zëvendësimin e disa greqizimeve ose ilirizimeve të kohës së hershme, por jo zëvendësimin e gjithë fondit të fjalëve kishtare ilire e greke, fond i cili ishte konsoliduar gjatë shekujve I-IV-t.

1. - Jacques, Edwin E. *The Albanians: An Ethnic History from the Prehistoric Times to the Present*, McFarland & Co Inc. 1995, 138-143. (Në botimin shqip f. 158-163).

- Po atje, Frashëri, Kristo. *Fillimet e Krishtëritimit në viset shqiptare*, “Studime Historike”, Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, nr. 1-2, 2000.

- Po atje, Frashëri, Kristo. *Fillimet e Krishtëritimit në viset shqiptare*, Shekulli, 23 Tetor 1998.

2. Çabej, Eqerem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, Vëll. I, 1982, vëllimet e tjera kanë dalë në vite të ndryshme.

3. Bonnet, Guillaume. *Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, Paris-France, 1998.

4. D'Angely, Robert. *Enigma nga Pellazgët te Shqiptarët*, Tiranë 1998, 44-232.

5. Bonnet, Guillaume. *Ibid.* f. 378.

6. Çabej, Eqerem. *Ibid.* vëll. I, f. 104.

7. Çabej, Eqerem. *Ibid.* vëll. VI, f. 123.

8. Çabej, Eqerem. *Ibid.*

**M**ë poshtë mund të ndiqni replikën e argumentuar të Ardian Vehbiut në lidhje me shkrimin mbi Krishtërimin dhe termat kishtarë të përdorur në Ilirët.

Lexova me interes punimin e kolegut dhe mikut tim z. Thanas Gjika për fillimet e krishtërimin në shqiptarë. Dua të komentoj këtu vetëm në lidhje me argumentet gjuhësore të punimit, meqë për çështje të fesë nuk kam ndonjë kompetencë.

Pa dashur ta vë në diskutim tezën se krishtërimin banorëve ilirë të territoreve ku jetojnë sot shqiptarët ua shpunë apostulli Pal me nxënësit e tij në vitet 50-60-të të shek I e. r., dua vetëm të shtoj se kjo nuk e përjashton e as e përgënjeshton tezën e evangjelizimit të protoshqiptarëve nga Roma.

Historikisht shën Pali fare mirë mund t'i ketë shkëlur i pari trojet ilire, por evangjelizimi është një proces masiv, që nuk bëhet nga një njeri vetëm. Gjuha shqipe nuk na thotë dot gjë nëse ka ardhur apo jo shën Pali në Iliri, por mund të na japë shumë të dhëna për kahun e evangjelizimit – nga Lindja apo nga Perëndimi.

Janë dy gjëra të ndryshme.

D'Angely ka qenë një amator dhe fantazist që nuk mund të përdoret për të kundërshtuar Çabejn dhe të tjerë latinistë seriozë që janë marrë me këto probleme. Tezat e D'Angely-t nuk i pranon kurrkush ndër dijetarët seriozë, përveç "kolegëve" të tij që kanë dalë së fundi si këpurdhat pas shiut, për të pështjelluar shoku-shokun dhe lexuesit e painformuar.

Ju thoni se "... Afërsia e madhe e shumë fjalëve të fondit themelor në gjuhën e sotme shqipe, në rumanisht, frëngjisht e spanjisht dhe në gjuhët nëna të tyre si ilirishtja, dakishtja, galishtja e keltishtja nuk duhen konsideruar thjesht latinizma, siç konsiderohen sot, por fjalë të trashëguara nga dialektet e gjuhës nënë, e gjuhës barbare, të cilën e fliste popullsia e përbashkët indoeuropiane e këtyre trojeve".

Kjo është e pasaktë. Në përgjithësi, është e lehtë të dallohen huazimet latine të shqipes nga fjalët e fondit autokton.

Z. Gjika, ju mund të mendoni ç'të doni për fjalën "kryq", por për të vënë në diskutim prejardhjen e saj jashtëzakonisht evidente nga latinishtja *crucem* duhen argumenta të forta (them *crucem* jo *crux* sepse shqipja zakonisht i ka marrë latinizmat në trajtën e kallëzores). Zhvillimet kuptimore të

fjalës "kryq" në shqip dhe pjesëmarrja e saj në kompozita nuk janë argumenta. Huazimet latine të protoshqipes konsiderohen si fjalë të brumit të shqipes, meqë këto kanë hyrë në gjuhë kur shqipja ende nuk ishte "shqipe", duke marrë pjesë, si të thuash, në krijimin e saj. Si të tilla, është e natyrshme që të jenë zhvilluar semantikisht dhe të kenë prodhuar edhe derivate të ndryshme. Fonetikisht, nuk ka asgjë që të kundërshtojë prejardhjen e "kryq" nga *crucem*.

Prejardhja e fjalës "këmborë" nga *campana* është pak a shumë e padiskutueshme. Folja "kumbon", në këtë rast, mund të merret fare mirë si një formim regresiv (sikurse "krip" nga "kripë", për shembull), në kuptimin "tingulli që nxjerr këmbora". Nga ana tjetër, etimologjia e kësaj fjale s'ka shumë lidhje me argumentin tonë. Më në fund, stërgjyshët tanë të neolitit vërtet mund t'ua kenë varur këmborët deshëve pararomakë, por kjo nuk do të thotë edhe se i kanë quajtur këto "këmborë" që atëherë. Emrat nuk duhen ngatërruar me sendet. Edhe Naimi thotë "Ku mërzen cjapi me zile", po kjo s'do të thotë se përmetarëve ua mësuan turqit që t'u varnin këmborë cjepëve. Apo të presim sa të dalë nesër ndonjë tjetër D'Angely, që të na thotë se turqit e morën fjalën "zile" nga frashërlliu i madh i shqiptarëve.

Përsa i përket shpjegimit tuaj mbi fjalët "pagëzoi", "pagëzim" ai është përsëri i pasaktë. Fjala "gëzoi" është derivat i një huazimi latin, "gaz" (nga *gaudium*). Kjo është e mirëditur.

Për supozimin tuaj se prejardhja e fjalëve "pagëzoi, pagëzim", etj, që duhen kërkuar në togfjalshat "gëzim i parë", "po gëzojmë së pari" nuk ka asnjë provë. Provë do të ishte (1) ekzistenca në shqipen e një modeli fjalëformimi ku rrokja nistore pa- do t'i përgjigjej kuptimit "i parë"; dhe (2) ekzistenca në gjuhë të tjera e një modeli semantik sipas të cilit koncepti i pagëzimit do të lidhej me konceptin e të gëzuarit.

Fjala "shenj" është provuar të vijë nga *sanctum*, ndërsa "shenj" nga *signum*. Askush nuk ka thënë – me sa di unë – që në shqipe këto fjalë të kenë lidhje etimologjike me njëra-tjetrën.

Ekzistenca e fjalës shqipe "frymë" nuk përgënjeshton hipotezën që krishtërimi u ka ardhur të parëve të shqiptarëve nga Roma (njëlloj sikurse fakti që Shqipëria është vend malor nuk e përjashton që ky vend ka vijë bregdetare).

Fjalët “i kërshenë/i krishterë” janë huazime tipike të protoshqipes nga latinishtja. Nuk ka ndonjë prapashtesë të rotacizuar të ilirishtes që të jetë dokumentuar në shqipen.

Disa greqizma vërtet kanë hyrë në terminologjinë kishtarë të shqipes, por këto janë fjalë të vona, kryesisht mesjetare. Të tjera greqizma të kësaj fushe kanë hyrë në protoshqipe nëpërmjet latinishtes, si p. sh. “kishë” ose “Krisht” (meqë evangjelizimi i Romës vetë u krye nga misionarë grekë ose greqishtfolës). Megjithë dëshirën e mirë të z. Gjika, shqipja nuk sjell asnjë provë të mirëfilltë kontaktesh midis evangjelistësh greqishtfolës dhe të parëve të shqiptarëve.

Si përfundim, dua të shtoj se etimologjia është degë shumë e vështirë e gjuhësisë, dhe kërkon

njohuri të thella edhe në fushën e fonetikës historike. Unë, që etimolog nuk jam as guxoj të jem, i komentoj hipotezat e z. Gjika duke u mbështetur në teza të mirënjohura të historisë së gjuhës shqipe – njëlloj sikurse nuk ka nevojë të jesh matematician i madh për të kundërshtuar dikë që pretendon se, brenda konceptit gjeometrik euklidian, mund të ekzistojnë trekëndësha ku njëra brinjë të jetë më e gjatë se shumica e dy brinjëve të tjera. Latinizmat e shqipes njihen mirë, janë studiuar me rrënjë dhe shërbejnë si bazë për t’ia rindërtuar kësaj gjuhe historinë parashkrimore. Me ato që thotë, z. Gjika tregon se nuk e ka studiuar mirë historinë e gjuhës sonë, as teknikat e rindërtimeve etimologjike.

Ardian Vehbiu

## Bruce Alberts

Emri Bruce Alberts nuk është i panjohur për studentët e biologjisë: ai është njëri nga autorët e librit-bibël *The Cell* (Qeliza). Për shumë të tjerë Alberts është presidenti aktual i Akademisë Kombëtare Amerikane të Shkencave, post të cilin ai e lëshoi më 1 korrik. Alberts është një lektor i apasionuar dhe me shumë ide inovative. Njëra nga këto ide është krijimi i një kursi të ri të shkencës në Universitetin e Kalifornisë, San Francisko. Në vend të leksioneve tradicionale, Alberts ka vendosur t’u shperndajë studentëve një grumbull artikujsh të zgjedhur me kujdes. Një diskutim midis studentësh mbi këto artikuj duhet të nxjerrë në pah se cilët artikuj përfaqësojnë punë të shkëlqyer shkencore dhe cilat jo. “Ne gjithmonë flasim për artikuj të shkëlqyer, - thotë Alberts, - por diskutojmë shumë pak për faktin që një pjesë e konsiderueshme e artikujve përfaqësojnë punë mediokre”.



Alberts preferon termin “të merzitshëm” për të gjithë ata artikuj që nuk arrijnë të pasurojnë themelet e shkencës botërore dhe që përshkruajnë punë që ndoshta nuk ja vlen fare të kryheshin. Qëllimi i tij është t’i bëjë studentët dhe shkencëtarët që të flasin për tema kritike të karrierës shkencore: si mëson një shkencëtar ku ta përdorë kohën, paratë dhe energjinë në mënyrën më efektive. “Mendoj se një kurs i përshtatshëm do të mund t’i ndihmonte shkencëtarët e ardhshëm të zhvillonin aftësitë e duhura për t’u bërë të suksesshëm” – thotë ai. Alberts është një shkencëtar me një biografi për t’u admiruar: anëtar i tetë akademive të huaja, 14 tituj nderi dhe një seri e gjatë publikimesh. Gjatë 12 vjetëve të drejtimit të Akademisë Amerikane të Shkencave ai ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme për të reformuar mënyrën e mësimdhënies së shkencës. E, megjithatë, rruga për të ardhur deri këtu nuk ka qenë e lehtë. Ai për pak sa dështoi së qënuri një shkencëtar, sepse mënyra se si ai kish studiuar shkencën nuk e kish mësuar të kuptonte kulturën shkencore të të mësuarit dhe të adresuarit të pyetjeve. “Edhe si një profesor i ri, mënyra e tij e mësimdhënies ishte patetike”, – pohon Alberts, – “sepse thjesht nuk dija ta bëja më mirë”. U desh një kohë e gjatë për të qenë në gjendje të formulonte atë që atij dhe sistemit shkollor amerikan ju mungonte. Para së gjithash, ai beson se edukimi i shkencës duhet t’i përngjasojë shkencës aktuale, ku pyetjet përse dhe si janë shumë më të rëndësishme se sa listimi i memorizuar i një serie faktesh.


Alberts mendon se njerëzit i motivon kënaqësia për të zgjidhur probleme dhe për t’u ndjerë kompetentë dhe, ky lloj motivimi, është i vlefshëm si për një shkencëtar brilant të së nesërme ashtu edhe për studentët e tjerë. “Unë jam i mendimit se procesi ynë i edukimit duhet të bëjë të mundur që çdo nxënës të kuptojë që është kompetent për dicka”, – thotë Alberts. “Rëndësia e edukimit të shkencës herët është më e rëndësishme se sa furnizimi i shkencës me shkencëtarët e së nesërme, rëndësia e këtij edukimi qëndron në të mësuarit e aftësive bazë, të strategjive për të përballuar jetën. Ne nuk duhet t’i mësojmë studentët që ata të bëhen shkencëtarë, ne duhet t’i mësojmë ata që të jenë në gjendje të zgjidhin çdo lloj problemi që ju del përpara në një mënyrë shkencore.

(pershtatur nga PNAS prej Albana Rexhepajt)

Një "vit i mrekullueshëm" viti 1905.

Njëqint vjet më parë Albert Ainshtajn paraqiti punimet e tij shkencore që sillnin ide revolucionare mbi tre çështje themelore bazë të fizikës moderne: ekzistenca e atomeve, natyra e dritës dhe konceptet e hapësirës, kohës, lëndës dhe energjisë.

Njëqint vjetori i këtyre zbulimeve u prit me entuziazëm nga komuniteti ndërkombëtar i fizikanëve për ti dedikuar pikërisht fizikës vitin 2005. Qysh në korrik të vitit 2004 një vendim i Asamblesë së përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e shpalli vitin 2005 International Year of Physics duke ftuar Unescon të organizojë veprimtari të shumta për të përkujtuar këtë vit në bashkëpunim me shoqëritë e grupet e fizikës në mbarë botën, përfshi edhe vendet në rrugën e zhvillimit.



**"Gjëja më e bukur që ne mund të eksperimentojmë është misteri. Eshtë burimi i të gjithë artit të vërtetë dhe i të gjitha shkencave."**

ALBERT EINSTEIN

Në *annus mirabilis* njëqint vjet më parë, njëzetegjashtëvjeçari Albert Ajnshtajn, prototipi i shkencëtarit gjenial, publikoi tre artikujt e tij revolucionarë. Për secilin prej tyre ia vlen të dimë idetë kryesore duke ia lënë detajet kuriozëve dhe studiuesve të mirëfilltë.

Artikulli mbi lëvizjen brauniane jep shpjegimin e një fenomeni që vëzhgoi biologu Robert Brown në villim të viteve 1800. Ai pa në mikroskop se kokrrizat e pjalmnit në ujë janë në lëvizje të vazhdueshme. Teoria e Ajnshtajnit merr parasysh këtë lëvizje rastësore duke pohuar praninë e molekulave të ujit që vazhdimisht përplasen me kokrrizat e pjalmnit. Atëhere, të pranoje ekzistencën e atomeve dhe molekulave nuk ishte një gjë kaq e lehtë sa ç'është sot. Atomet nuk mund të shihen as me sy të lirë e as me mikroskop pasi përmasat e tyre nuk mund të dallohen nga asnjë instrument optik. Fakti që lënda formohet nga atome e molekula pranohej nga një numër i madh por jo nga krejt komuniteti shkencor. Skeptikëve iu mbyll goja pikërisht nga shpjegimi teorik i Ajnshtajnit.

Sot teknologjia moderne lejon që të shihet edhe në nivele tepër të hollësishme: ekziston mikroskopi me skansion "tuneli" që dallon edhe praninë e atomeve të veçantë shumë të vegjël.

Artikulli i dytë i Ajnshtajnit bënte fjalë për efektin fotoelektrik që është ai fenomen kur një metal goditet nga një lloj drite lëshon ngarkesa elektrike (elektrone). Shpjegimi i Ajnshtajnit mbështetet në faktin se drita përbëhet nga një bashkësi "grimcash" me një energji të përcaktuar mirë. Çdo grimcë (apo kuant ose foton siç u quajt më vonë) ia jep energjinë e tij një elektroni i cili si pasojë arrin të dalë nga metali e të vihet re. Ideja

që energjia e shkëmbyer midis dritës dhe lëndës kish disa vlera të caktuara e jo çfarëdo vlere nuk ishte e re. E kish propozuar pesë vjet më parë fizikani gjerman Max Planck për të justifikuar sjelljen e trupave të ashtuquajtur "të zinj" (bëhej fjalë për të kuptuar mekanizmin e lëshimit të energjisë nga disa lloj trupash si p.sh. yjet, në disa temperatura të caktuara). Planck hipotezoi me keqardhje ekzistencën e "paketave" të energjisë edhe pse ai nuk ishte plotësisht i bindur për sensin fizik të teorisë së tij. "Grimcat" e dritës që janë të çuditshme: shkëmbejnë sasi të vogla energjie, janë gjithmonë në lëvizje me një shpejtësi marramendëse prej 300000 km/s, e disa here nuk shfaqen fare duke bërë që drita të duket si një valë. Megjithë këto karakteristika të çuditshme, ekzistenca e tyre u vërtetua më pas edhe nga shumë eksperimente të tjerë. Jo vetëm kaq. Fakti që energjia mund të merrte disa vlera e jo të gjitha, hapi rrugë të reja për fizikën dhe për interpretimet të reja të këtyre fenomeneve. Për shpjegimin e efektit fotoelektrik Ajnshtajnit në vitin 1921 iu dha çmimi Nobel. Sot nuk është e vështirë të hasësh objekte që bazohen në këtë fenomen: mjafton të përmendim celulat fotoelektrike që na ndihmojnë çdo ditë të hapim e mbyllim mekanizma e qarqe të natyrave të ndryshme.

Publikimi i tretë ka të bëjë me relativitetin e kjo teori edhe sot e kësaj dite diskutohet e diskutohet. Me termin "relativitet" është abuzuar gjerësisht e ai është përdorur edhe në kontekste ku teoria e Ajnshtajnit nuk hyn fare.

Por për çfarë bën fjalë kjo teori?

Para së gjithash duhen dalluar brenda teorisë dy relativitete: ai "special" (ose "i ngushtë") dhe relati-



teti "i përgjithshëm". Që të dy janë formuluar nga Ajnshtajni: i pari më 1905 e i dyti më 1916. Problemi që qendron në bazën e të dyve është i njejtë.

Çështja që do të zgjidhë Ajnshtajni është si vijon.

Ka ligje fizike që shpjegojnë shumë fenomene të ndryshëm (nga rënia e mollës mbi kokën e Njutonit tek rrotullimi i gjilpërës së busullës). Megjithatë, duket se këto ligje nuk përshkruajnë më të njejtët fenomene nëse ata ndodhin në një tren në lëvizje. Por, Ajnshtajni thotë se lëvizja nuk mund të ndryshojë shkaqet dhe mënyrën e një ngjarjeje. Duhet të ekzistojë një rrugë për të lidhur atë që ndodh në duart e tua me atë që ndodh në duart e një bashkudhëtari tjetër. Dhe kjo rrugë ekziston. Në të vërtetë, ideja e "vënies në komunikim" të udhëtarit me atë që "rri në vend" është 400 vjet e vjetër. Galileo Galilei bëri të njejtën pyetje dhe gjeti një përgjigje që qendroi për katër shekuj deri tek Ajnshtajni. Një nga shembujt e përmendur nga Galileo ishte ky: nëse dikush duke qendruar në molin e portit do të përshkruajë lëvizjen e një mize mbi një barkë që lëviz me shpejtësi të njejtë, duhet ti shtojë shpejtësisë së insektit edhe shpejtësinë e barkës. Kjo zgjidhje është e drejtë derisa flitet për miza, barka, kuaj e trena por kur ke të bësh me dritën (me shpejtësi 300.000 km/s) apo me elektrona që arrijnë shpejtësi të përafërt me atë të dritës atëhere "rregulla" e Galileos nuk funksionon më. Ajo u ndryshua pikërisht nga Ajnshtajni në kuadrin e relativitetit specifik. Është një rregull jo shumë e vështirë por ajo mbështetet mbi dy ide të vështira për tu pranuar. Së pari, drita ka gjithmonë një shpejtësi 300.000 km/s e kjo shpejtësi është e njejtë si kur matet në mol ashtu edhe kur matet në barkë. Së dyti, edhe koha e matur nga ai që udhëton duhet të jetë e lidhur me atë që mat ai që qendron pa lëvizur: koha nuk ecën në të njejtën mënyrë. Pasoja është që ora në barkë vonohet në krahasim me atë që është në mol. Por, kujdes! Që të kemi ndryshim midis dy orëve të matjes, barka duhet të ecë me shpejtësi tepër të lartë.

Nëse deri këtu gjërat e thëna vazhdojnë të duken si një slalom midis formulime teorish e formula le të nxjerrim në pah revolucionin konceptual që solli relativiteti: hapësira dhe koha janë të lidhura ngushtë midis tyre; nuk mund të dimë një pozicion nëse nuk njihet edhe koha ose anasjelltas.

Nga teoria e relativitetit specifik rrjedhin të tjerë koncepte të mëdhenj fizike: masa dhe energjia. Ato janë "e njejtë gjë", masa është energji dhe energjia është masë. Lidhja midis tyre është sintetizuar në formulën e famshme  $E = mc^2$ : energjia që ka një farë mase është

e barabartë me vlerën e asaj mase të shumëzuar me shpejtësinë e dritës në katror. Dhe pasojat nuk janë të pakta, për të mirë e për të keq.

Po relativiteti i përgjithshëm?

Siç thamë edhe më lart, pikënisja për të dyja teoritë është e njejtë: njohja e vlerës së ligjeve të njejtë për sistemet në lëvizje.

Tek relativiteti specifik, "lëvizja" është e veçantë, e përshkruar nga një shpejtësi vlera dhe drejtimi i së cilës qendrojnë gjithmonë të njejtë. Relativiteti i përgjithshëm arrin të përfshijë edhe lëvizjet e shpejta në të cilat shpejtësia ndryshon. Në këtë rast, që udhëtarit (që këtë herë supozojmë se ndodhet në një ashensor ose në një raketë në ngjitje) të mund të komunikojë me shokun e tij në tokë duhet të përdorë "rregulla" të tjera, matematikisht më të komplikua.

Çështja e matematikës është interesante: siç thotë vetë Ajnshtajni, "atëhere nuk ishte vështirë të zgjidhje problemin sepse konceptet e nevojshëm matematikë ishin gati", por nëse problemin e shqyrtonin mendimtarët e shekullit XVII-të (gjë që një pjesë e bënë) "ata nuk do të kishin bazat e nevojshme empirike dhe teorike" për të arritur të formulonin një teori. Matematika mbi të cilën mbështetet relativiteti i takon matematikanit Riemann (që jetoi në mesin e shek. XVII) dhe gjeometria është ajo e Levi-Civita (matematikan italian që jetoi midis viteve 1800-1900).

Kjo teori paraqet një tjetër shkrirje të madhësive fizike: hapësirës dhe kohës i bashkohet graviteti. Është kjo rëndesë, pra prania e masave, që përcakton "formën" e hapësirës dhe të kohës; në veçanti, mungesa e trupave i le vendin një hapësire të sheshtë ndërsa prania e masave kushtëzon një hapësirë aq të kurbuar sa më të mëdha janë masat. Ato tërhiqen e tentojnë të bien njera mbi tjetrën ashtu si një sferë që rrotullohet në rrugë tenton të bjerë në një vrimë. Por një lexues i vëmendshëm që kujton atë që thamë më lart se masa është energji mund të mendojë: drita që është energji duhet të sillet si një masë e kështu duhet të tërhiqet nga një trup tjetër. Dhe në fakt kështu ndodh. Një rreze drite devijohet nga trajektorja e drejtë në prani të një mase: ky parashikim është vërtetuar shumë herë eksperimentalisht dhe është një efekt i njohur mirë sidomos nga astronomët që vëshgojnë objekte qiellore të fshehur pas të tjerëve.

Besojmë se kaq mjafton për të justifikuar një vit që i dedikohet fizikës, figurës së Ajnshtajnit dhe paraardhësve të tij sepse nuk duhet të harrojmë që çdo gjeni i madh lind "mbi shpatullat e gjigantëve".

**Përgatiti Roland Leli**

## PROJEKTI I VEPRËS SË AJNSHTAJNIT

«Si ka mundësi që askush nuk më kupton dhe, megjithatë, të gjithë më pëlqejnë?»

Në një nga firmat më ambicioze të “shkencave historike” dhe të botimeve po punohet prej vitesh për të botuar një seri librash me titullin: *Përmbledhje e botimeve të Ajnshtajnit* ku do të përfshihen publikimet shkencore të tij. Kjo seri do të përfshijë mbi 40 vëllime të cilat do të përmbledhin mbi 14000 dokumente. Ky projekt sponsorizohet nga Hebrew University of Jerusalem dhe Princeton University Press.

Në bazë të planifikimit të tanishëm, parashikohet që vëllimi i fundit të botohet në vitin 2017. Seria e vëllimeve, e cila është e ndërtuar në mënyrë kronologjike, përbëhet prej dy pjesësh: *Writings* dhe *Correspondence*. *Writings*, përveç të tjerave do të përmbajë artikuj shkencorë, shënime dhe leksione të botuara dhe të pa botuara të Ajnshtajnit. Pjesa tjetër, *Correspondence*, do të përmbajë përveç të tjerave, letra të shkruara nga fizikani i madh, si dhe letra drejtuar atij dhe dokumenta të rëndësishme.

Në këtë seri librash dokumentat do të sillen në gjuhën në të cilën ato janë shkruar, ndërsa të tjerat do të sillen në gjuhën angeze. Me këtë përmbledhje botimesh do t'i ngrihet një monument gjenit më të madh të shkencës së këtij shekulli.

Një gazetë amerikane komentonte këtë ngjarje kështu: “Ajnshtajni nuk dëshironte një monument; ky monument është i vetmi që ai duhej ta pranonte.”

Vëllimet e botuara deri tani:

Band 1, *The Early Years: 1879-1902*

Band 2, *The Swiss Years: Writings, 1900-1909*

Band 3, *The Swiss Years: Writings, 1909-1911*

Band 4, *The Swiss Years: Writings, 1912-1914*

Band 5, *The Swiss Years: Correspondence, 1902-1914*

Band 6, *The Berlin Years: Writings, 1914-1917*

Band 7, *The Berlin Years: Writings, 1918-1921*

Band 8, Teil A, *The Berlin Years: Correspondence, 1914-1917*

Band 8, Teil B, *The Berlin Years: Correspondence, 1918*

Band 9, *The Berlin Years: Correspondence, 1919-1920*

**Përgatiti Robert Duçellari**

## Asnjë paradoks për udhëtarët e kohës

Udhëtimi në kohë është i mundur dhe pa paradokse. Këtë përfundim kanë nxjerrë dy studiues, Daniel Greenberger në City University, New York dhe Karl Svozil në Vienna University of Technology, që kanë paraqitur një dokument në sitin web arxiv.org.

Sipas dy fizikanëve ligjet e fizikës kuantike i bëjnë paradokset të pamundur dhe me to edhe përfundimet më spektakolare të udhëtimit në kohë.

Disa zgjidhje të ekuacioneve të Ajnshtajnit lidhur me Teorinë e relativitetit të përgjithshëm duket sikur tregojnë se në ndonjë situatë hapësira-koha kthehet mbi vetveten duke lejuar disa udhëtarë të mundshëm të kthehen në të kaluarën, bile të takojnë veten e tyre në atë kohë. Dy shkencëtarët megjithatë mendojnë se kjo mund të ndodhë pa ndryshuar ngjarjet tashme të ndodhura.

Kjo varet nga fizika kuantike: një objekt kuantik

ka mundësi që të sillet si një valë e secila nga valët në të cilat ndahet ekzistenca e një objekti kuantik ndjek një itinerar të caktuar në hapësirë-kohë. Një objekt shkon atje ku valët e tij përbërëse rikombinohen me njera-tjetrën në mënyrë konstruktive. Kur në të kundërt ndodh interferimi midis tyre në mënyrë negative e anullojnë njera-tjetrën është e pamundur të gjesh objektin kuantik.

Asgjë në teorinë kuantike pengon këto valë të shkojnë mbrapa gjë që lejon udhëtimet në kohë. Por, duke shkuar mbrapa valët kanë një interferim negativ midis tyre e kështu pengojnë ndryshimin e asaj që ka ndodhur në të shkuarën kuantike.

“Nëse udhëtohet mbrapa në kohën kuantike, mund të shihen alternativat lidhur me botën që kemi lënë pas”, përfundon Greenberger.

*New Scientist*

## Një yll-laborator vërteton teorinë e Ajnshtajnit

PSR J0737-3039, pulsari i dyfishtë i zbuluar në fund të vitit 2003 nga Grupi i Radioastronomisë, INAF dhe Universiteti i Kaljarit (Itali) rezultoi të jetë një laborator kozmik i rëndësishëm që vërteton Teorinë e Relativitetit të Ajnshtajnit. Falë saktësisë së lartë të periudhës së rrotullimit të njerit prej yjeve të neutroneve që përbëjnë këtë sistem u arrit të matej “ngushtimi” i orbitës së tyre, në përputhje të shkëlqyeshme me parashikimet e Relativitetit të Përgjithshëm. Një kontribut i rëndësishëm shkencor ky që koïncidon me Vitin Botëror të Fizikës.

Zbulimi i shkencëtarët italianë të një sistemi me dy yje neutronesh që pulsonin ishte i rëndësishëm sepse ky është i vetmi sistem i njohur ku të dy yjet lëshojnë sinjale radio dhe njeri prej tyre është një “orë kozmike” me saktësi të lartë. Publikimi i këtij zbulimi është më i cituari për gjithë vitin 2004 në fushën e shkencave të hapësirës.

Dy yje neuronesh që rrotullohen shumë shpejt rreth njeri-tjetrit duhet që, për shkak të relativitetit, të humbin shumë shpejt energjinë dhe të ndërrojnë orbitën e tyre duke “u ngushtuar” ndjeshëm. Qysh nga janari 2004 vëzhgimi vazhdon

pandërprerje me tre radioteleskopë gjigantë në Australi, ShBA e Angli në kuadër tashmë të një bashkëpunimi ndërkombëtar italo-anglo-amerikano-australian.

Të dhënat e grumbulluara gjatë kësaj kohe tregojnë se dy yjet afrohen 7mm në ditë dhe kjo do të çojë në përplasjen e pulsarëve pas 85 milionë vjetësh. Ngushtimi i orbitave të tyre është në përputhje të plotë me vlerat e llogaritura për PSR J0737-3039 sipas Teorisë së Relativitetit.

Edhe një karakteristikë tjetër mund të shpjegohet në bazë të Teorisë së Ajnshtajnit: sinjalet radio që lëshon njeri prej pulsarëve, që duhet të jenë tepër të rregullt, kanë ndryshime të vogla në formë dhe kohëzgjatje. Këto ndryshime të rregjistruara nga radioteleskopët ndodhin nga një luhajtje e boshtit rrotullues të pulsarëve e cila shkaktohet nga forca e lartë e gravitetit që prodhohet nga trupat qiellorë. Yjet lëvizin në orbitën e tyre në një zonë hapësirë-kohë të pjerrët, si një anije në një det me dallgë. Kështu, sinjalet që ato lëshojnë rezultojnë i ndryshëm në mënyrë ciklike ashtu siç rregjistrohet në tokë nga radioteleskopët.

*INAF (Istituto Nazionale di Astrofisica)*

## Sqarohet misteri i molekulave të hidrogjenit në Univers

Motivi për të cilin hidrogjeni i pranishëm në Univers gjendet në formë diatomike e jo me atome të veçuar më së fundi u zbulua.

Zgjidhja u ilustrua nga modeli i kompjuterizuar nga studiuesit e udhëhequr prej Eric Herbst në Ohio State University di Columbus, të cilët i paraqitën rezultatet e tyre në simpoziumin mbi spektroskopinë molekulare të mbajtur ditët e fundit në të njëjtin universitet amerikan.

Hidrogjeni është elementi më i bollshëm në Univers duke zënë rreth 90% të peshës së tij. Vlerësohet se rreth gjysma e këtij hidrogjeni gjendet në formë molekulare. Në brendësi të nebulave të dendura ku formohen yjet, gati i gjithë hidrogjeni është në formë molekulare.

Deri tani mendohej se ky fenomen i dedikohet pranishë së pluhurave të cilëve atomet e hidrogjenit iu ngjiteshin duke formuar molekulat diatomike H<sub>2</sub>. Por një eksperiment i kryer në vitet Nëntëdhjetë e hodhi poshtë këtë teori.

Eksperimenti i kryer nga Gianfranco Vidali në

Syracuse University, tregoi se hidrogjeni molekular formohej vetëm në temperatura më të ulëta se ajo në brendësi të reve ndëryjore.

Sipas Herbst, ndryshimi qendron tek struktura e pluhurit. Mjafton që atë ta bësh më të çrregullt (teoria e parë mbështeste se kokrrizat e pluhurit ishin të lëmuara) e hidrogjeni arrin të bashkohet në mënyrë më efikase.

Një rezultat ky, edhe pse vetëm teorik, që nxiti Vidalin të thotë se do ta përsërisë eksperimentin e tij duke përdorur pluhur “të çrregullt”. Por, deri sa të arrijë rezultate konkrete ky fizikan nuk thotë gjë për vlerën e modelit të propozuar nga Herbst. “Sipërfaqet e çrregullta mund të rrisin efikasitetin e bashkimit të atomeve të veçantë në molekula por është e vështirë të vërtetojmë se sa dhe kur ndodh ky bashkim” thotë eksperti, duke theksuar se në brendësi të reve efikasiteti është maksimal meqë hidrogjeni është krejtësisht apo gati krejtësisht në formë molekulash.

*Nature*

**DUKE FILLUAR NGA KY NUMËR I BULETINIT ALB-SHKENCA KEMI MENDUAR TË PUBLIKOJMË NJË INTERVISTË ME NJË SHKENCËTAR APO STUDENT TË SUKSESSHËM SHQIPTAR PËR TI NJOHUR MË NGA AFËR ATA. PO E HAPIM KËTË RUBRIKË TË RE ME PORTRETIN E KUJTIM LATIFIT, STUDIUES NË LABORATORIN FIZIK ARGONNE NATIONAL LABORATORY QË KOINCIDON EDHE ME VITIN BOTËTOR TË FIZIKËS QË PËRMENDËM NË FAQET E MËPARSHME.**

**Alb-Shkenca:** *Kujtim çfarë je duke studiuar dhe në cilën fazë të këtyre studimeve je?*

**Kujtim Latifi:** Tani jam graduate student në fizikë dhe po ndjek studimet në Northern Illinois University (NIU), në degën Fizika e lëndëve të kondensuara (Condensed Matter Physics). Sapo kam përfunduar vitin e parë të studimeve. Ka mbetur edhe pak për ti përfunduar e më pas do të merrem vetëm me kërkime. Studimet per bachelor i kreu në Universitetin e Denverit po në fizikë, në qershor 2004 me Bachelor of Science.

**A-Sh:** *A është e vështirë dega që studioni dhe përse zgjodhët atë?*

**KS:** Po, secila degë i ka vështirësitë e saj, varet se ç'ka shikon. Fizika është ndoshta njera ndër më të vështirat, por edhe njera ndër më interesantet për t'u studiuar. Me kuptimin e fizikës njeriu kupton natyrën dhe ligjet e saj, por edhe vetë ekzistencën tonë në këtë botë. Fizika më hyri në zemër qysh në shkollën fillore, nga një mësuese fizike shumë e zonja që e kish punën e saj pasion. Më pas në gjimnaz profesori i fizikës ishte njeri ndër më të mirët dhe qysh atëhere vendosa që në të ardhmen të studioj fizikë.

**A-Sh:** *Çfarë teme do të dëshiroje të zgjidhje për doktoraturën?*

**KL:** Ende nuk kam vendosur gjë specifike por besoj se do të kete të bëjë me ferroelektricitetin. Vitin e parë i jam përkushtuar kryesisht studimeve në elektromagnetizëm, mekanike kuantike, fizikë klasike, fizikë statistikore etj. Para disa muajsh kam filluar këtu në Argonne National Laboratory të merrem me kërkime në materiale ferroelektrike. Si student pasuniversitar (graduate student) bëj pjesë në grupin studimor që quhet BESSRC (Basic Energy Sciences Synchrotron Radiation Center) e që përbëhet nga shkencëtarë prej Argonne dhe Northern Illinois University. Ky grup ka nëngrupet e tij të cilat merren me studime më specifike. Nëngrupi ynë merret me filmat e hollë ferroelektrike (Ferroelectric Thin Films). Arsyeja e studimit të këtyre materialeve është se ata janë shumë me rëndësi për përdorimin në

elektronikë, sisteme satelitore, telefonë celulare etj. Materialet ferroelektrike ka mundësi që të zëvendësojnë memoriet e silicit që përdoren tani.

**A-Sh:** *Si duhet ti përfytyrojë një njeri i thjeshtë ferroelektricitetin dhe materialet ferroelektrike?*

**KS:** Ferroelektriciteti është një veti e materialeve që kanë moment bipolar të përhershëm. Kjo veti mund të përdoret në elektronikë si kujtesë (RAM). Përparësia e këtyre materialeve ndaj silicit qëndron tek kujtesa që quhet nonvolatile, d.m.th. kur ndërpritet rryma të dhënat nuk humbasin. Po ashtu kjo kujtesë ka mundësi që të ruajë shumë më tepër informacion në një vëllim shumë më të vogël se kujtesat silicore. Vetia e ferroelektricitetit është mjaft e njohur në lëndët makroskopike, por kur masa e materialit zvogëlohet deri në disa nanometra këto materiale ndryshojnë vetitë e tyre. Në studiojmë se si këto veti ndryshojnë me ndryshimin e madhësisë së tyre, në çfarë temperaturash këto veti janë më të mira, sa të hollë mund të jenë këta filma deri sa ta humbin ferroelektricitetin? (Ne kemi arritur të bëjme filma të hollë deri në 3-4 nanometra që i ruajnë ende vetitë ferroelektrike). Ne kemi gjithashtu mundësinë që të zhvillojmë *thin films* dhe po ashtu të studiojmë se si zhvillohen ata. Ka disa metoda të zhvillimit të filmave si Pulsed Laser Deposition (PLD), Metalorganic Chemical Vapor Deposition (MOCVD), etj. Ne përdorim metodën MOCVD, me anë të së cilës gaze organike me përbërje plumbi, titaniu dhe zirkoniu (mvarësisht se çfarë përbërje ne dëshirojmë) depozitohen në mënyrë të rregullt në një substrat duke bërë të mundur zhvillimin e filmave të hollë. Gjatë zhvillimit të tyre me anë të rrezeve X mund të kontrollohet trashësia dhe mund të studiohen vetitë e tyre. Pasi kryhet zhvillimi i tyre (që mund të zgjasë disa minuta deri në disa orë, mvarësisht nga trashësia që dëshirojmë) studiohet sipërfaqja e tyre me rreze X ose me anë të mikroskopit atomik.

Advanced Photon Source financohet nga Departamenti i energjisë i ShBA-së dhe mund të përdoret nga studiues nga e gjithë bota. Personi që dëshiron të përdorë ndonjë instrument këtu, duhet të shkruajë një propozim dhe të kërkojë një datë për të kryer kërkimin në fjalë.

**A-Sh:** *A do jua këshilloj të tjerëve të studionin në Argonne dhe APS?*

**KL:** Për studentët që janë të interesuar të bëjnë kërkime postdiplomike, Argonne dhe APS janë shumë të përshtatshëm. Nëse ata pranohen Argonne paguan një rrogë të vogël për jetesë dhe shpenzime të tjera. Po ashtu ia gjen një këshilltar

me të cilin studenti i ri do të kryejë kërkimet e tij. Të interesuarit mund të gjejnë të dhëna në adresën elektronike <http://www.anl.gov/Careers/Education/index.html>.

**A-Sh:** *Ti ke shkuar në Amerikë nga Gjilani, si shumë të tjerë për shkak të luftës, në klasën e 12-të (viti i katërt gjimnaz). A ishte i vështirë kalimi nga njeri sistem shkollor tek tjetri?*

**KL:** Sistemi i mesëm shkollor në Amerikë nuk është edhe aq i vështirë. Përsa i përket lëndëve mësimore nuk hasa vështirësi të mëdha por në fillim, gjatë 2-3 muajve të parë, kisha pengesat gjuhësore. Por, pata fatin e madh që të jetoja në një familje amerikane dhe ata më ndihmuan shumë t'i kapërcej ato pengesa.

**A-Sh:** *Ku e sheh të ardhmen tënde?*

**KL:** Të ardhmen time e shoh në një laborator kërkimesh diku në Kosovë; shpresoj se kjo do të ndodhë shpejt.

**A-Sh:** *Si e sheh të ardhmen e fushës që ti kërkon t'i dedikohesh në Kosovë?*

**KL:** Me thënë të drejten, nuk e di se çfarë kush-tesh ekzistojnë në Kosovë tani për tani për kërkime në fizikë, apo për këto lloj kërkimesh që bëj aktualisht këtu. Por me durim do ti bëjmë edhe atje, edhe pse ndoshta do të duhet pak kohë. Në fillim është me rëndësi që të lidhim kontaktet me studiues nga vende dhe fondacione të ndryshme, që ta fusim këmbën në derë.

**A-Sh:** *Çfarë do të dëshiroje t'iu thojë moshatarëve të tu?*

**KL:** "I want to know God's thoughts; the rest are

details." (Albert Einstein).

Jam i bindur se shkencë do t'ia japë mundësinë secilit që ta kuptojë edhe natyrën edhe prejardhjen tonë. "Të gjitha të tjerat janë histori", siç thotë Ajnshtajni.

## DY FIALE MBI ARGONNE NATIONAL LABORATORY

**A**rgonne National Laboratory gjendet në afërsi të Çikagos, në shtetin Illinois. Këtu punojnë rreth 4000 shkencëtarë dhe ndihmës, në mesin e të cilëve edhe nobelista. Ky laborator ishte i pari laborator kombëtar në ShBA. Së pari u hap dikur pas Luftës së Dytë Botërore dhe kryheshin studime në fizikë bërthamore. Themeluesi i tij është fizikani italo-amerikan Enrico Fermi. Argonne përbehej nga një numër i madh departamentesh pak a shumë si një universitet. Në përbërje të tij janë fizika, kimia, shkencat e materialeve, fizika e energjisë së lartë etj. Në vitin 1995 këtij laboratoriu shtua edhe Advanced Photon Source (APS) që është një sinkrotron i cili prodhon rreze X me cilësinë më të mirë në botë. Këto rreze përdoren për studime të ndryshme në shumë fusha të shkencës, mjekësisë, mjedisit etj.

Advanced Photon Source është i ndërtuar në formë unaze ku futen elektrone të cilët bëhen që të nxitojnë me një shpejtësi pranë asaj të dritës. Këta elektrone kalojnë nëpër disa magnete të fortë të cilët i bëjnë që të lëshojnë fotone në formë rrezesh X. Në çdo tangjente të kësaj unaze një rreze me energji të lartë çlirohet dhe më vonë përdoret nga shkencëtarët për nevojat e tyre.

Për më shumë të dhëna rreth Argonne National Laboratory mund të vizitoni faqen elektronike [www.anl.gov](http://www.anl.gov).

Përgatiti Albana Rexhepaj

## Krijohet izotopi i zinkut 54

Një grup ndërkombëtar fizikanësh nuklearë krijoi për herë të parë izotopin zink-54. Sikur të mos mjaftonte kjo, shkencëtarët pohuan se ky element mund të reduktohet me dy protone, një proces i rallë ky që deri tani është vëzhguar vetëm tek një tjetër izotop. Rezultatet për tu publikuar në *Physical Review Letters* do të japin të dhëna të reja mbi lidhjet e protoneve në bërthamë.

Në një eksperiment të kryer në laboratorin GANIL, në Francë, Bertram Blank i Qendrës së studimeve bërthamore të Bordosë (CENBG) me kolegët e tjerë krijuan zinkun-54 që përmban 30 protone dhe 24 neutrone. Kjo u arrit pas bombar-

dimit me jone nikeli-58 të një objekti nikeli. Bërthamat e zinkut-54 u krijuan në një përplasje aksidentale ndër rreth 1017 të tilla dhe Black me kolegët panë se jeta e tyre mesatare (rreth 3.7 milisekonda) është në vijë me parashikimet.

"Të kesh në dispozicion një dërgues të dytë të dy protoneve – shpjegon Blank – do të na lejojë të krahasojmë më mirë teorinë me eksperimentet, gjë kjo shumë e vështirë për tu kryer kur ke vetëm një rast". Grupi i studiuesve parashikon që të kërkojë izotope të tjerë që kanë sjellje të ngjashme.

## NJE MONOGRAFI PER T'I NJOHUR ME THELLE VLERAT ARTISTIKE E ESTETIKE TE FOLKLORIT MBAREKOMBETAR

Monografia e Zymer Ujkan Nezirit *Poetika e krahasimit*, e botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, është një pjesë studimore e realizuar e projektit afatgjatë të IAP-it «Figuracioni poetik në lirikën popullore shqiptare», i propozuar qysh më 1972 nga profesori i nderuar Anton Çeta.

Monografia është një dokument me vlerë shkencore, e hartuar një çerek shekulli më parë dhe përbën një dëshmi të synimeve të autorit e të IAP-it për të trajtuar një problematikë të rëndësishme teorike stilistike e estetike në bazë të materialit të begatë të folklorit tonë mbarëkombëtar dhe të studimeve të mëparshme të kësaj tematike nga studiues shqiptarë e të huaj.

Ndonëse e shkruar shumë kohë më parë, vepra e z. Neziri, për shkak të meritave të saj, tingëllon bashkëkohore, e freskët dhe e rëndësishme edhe në suazë të gjithë përpjekjeve që vazhdojnë të kryhen për t'i njohur më thellë vlerat artistike e estetike të folklorit mbarëkombëtar. Studimi shkencor i poetikës së folklorit tonë vazhdon të jetë një problem i madh e aktual, pavarësisht nga arritje jo të pakta të derisotme. Veç të tjerash, zgjidhja e kësaj detyre ka rëndësi jo vetëm për folkloristikën, por edhe për hartimin e teksteve teorike të stilistikës letrare në përgjithësi, e cila ka qenë ndërtuar kryesisht sipas modeleve të letërsisë së kultivuar dhe të modeleve të letërsive të vendeve të tjera. Shpesh herë edhe shembujt që përdoren në këto tekste huazoheshin krejtësisht ose pjesërisht nga këto letërsi. Prandaj, është një hap i rëndësishëm, që disa nga folkloristët tanë të mirënjohur si Q. Haxhihasani, Rr. Berisha edhe Z. Neziri, plotësojnë njohjen e shumë aspekteve të poetikës së folklorit, që do të reflektohet edhe në tekstet e teorisë së letërsisë dhe të stilistikës, për të qenë më pranë vlerave dhe origjinalitetit të kulturës poetike të vendit tonë.

Kuptohet se tipet kryesore të figuracionit poetik e stilistik, të prozodisë e të aspekteve të tjera jo vetëm të poezisë folklorike, por edhe të poezisë së kultivuar, sado origjinale e të veçanta të jenë nga njëri vend në tjetrin, përftohen në shumicën dërrmuese të rasteve edhe si arketipe e modele të përgjithshme, prandaj edhe klasifikimet e tyre në vende të ndryshme kanë përfutur e përfutur karakter universal, si për shembull, metafora, simboli, epiteti, metonimia, sinekdoka etj. Kështu

ndodh edhe në fusha të tjera të arteve, në të cilat ekzistojnë «arketipe» ose zhanre e figuracion, që kanë vlerë formale universale, pavarësisht nga lënda e prejardhjes fillestare,

**Prof. Alfred Uçi**  
si në muzikë: suita, uvertura, simfonia, tonaliteti, ritmi etj. në letërsi – tregimi, novela, romani, romanca, lirika, epika etj.

Dhe mendoj se një meritë e monografisë së z. Nezirit qëndron në faktin se ai e ka ndjerë dhe njohur thellë atë raport që ekziston, edhe në një figurë të përveçme stilistike si krahasimi, midis origjinalitetit e veçorive kombëtare (folklorit) dhe modeleve universale të poetikës stilistike të përgjithshme. Prandaj, në këtë monografi gërshetohen dy faktorë, nga njëra anë, zotërimi i ideve kryesore të literaturës shkencore teorike, që i jep siguri autorit në qëndrimet e vlerësimet e krahasimit, si figurë artistike dhe, nga ana tjetër, ai i është drejtuar folklorit tonë, në të cilin gjen një pasuri të madhe e të larmishme shembujsh, që i jep siguri edhe për origjinalitetin dhe klasifikimin e tipeve kryesore të krahasimeve në poezinë folklorike lirike të dashurisë.

Autori ka vepruar drejt duke përfshirë jo thjesht disa shembuj të rëndomtë krahasimesh nga kjo fushë, por duke zgjedhur e përfaqësuar gjithë trevat kryesore të folklorit, të Jugut e të Veriut, të krahinave brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe të Kosovës, Maqedonisë e diasporës. Në këtë rrugë edhe përfundimet marrin karakter të përgjithshëm dhe bëhen bindëse për gjithë tipet kryesore të përdorimit të krahasimit. Z. Neziri në monografinë e tij kriteret e klasifikimit të tipologjisë dhe të vlerave estetike të shembujve i përcakton, duke shmangur njëanësinë, përkundrazi, ai materialin konkret folklorik e shqyrton në mënyrë komplekse, domethënë duke çmuar aspektet formale të krahasimit dhe ato substanciale kuptimore, ideore, strukturore e funksionale, gjuhësore dhe estetike. Kjo metodikë e shqyrtimit kompleks është zbatuar gati në secilin shembull, me analizë të qartë e gjithnjë komplekse.

Është me rëndësi që autori ka ditur të kombinojë në vlerësimin e çdo modeli jo vetëm metodikën kritiko-pedagogjike, që u dhuron analizave qartësi e përcaktueshmëri, por edhe inkuadrimit e tyre në rrafsh teoriko-estetik. Kuptohet se në folklor vlerat estetike kanë veçori e origjinalitet në krahasim me letërsinë e kultivuar dhe estetikën teorike, por gjithsesi ka një estetikë të folklorit e trajtimi nga kjo pikëpamje ndihmon jo vetëm për të zbuluar e shprehur thelbin e krahasimit në lirikën e

dashurisë, por edhe për të arritur në konkluzione estetike teorike, domethënë që fitojnë karakter të përgjithshëm, që shprehin jo vetëm vetitë e shembujve të veçantë që janë përdorur për ilustrim, por edhe çka pritet të gjendet në shembuj të mundshëm jo vetëm ende të panjohur, por edhe ende të pakrijuar. Këtë aspekt ne e theksojmë, sepse përmes estetikës mund të arrihet në konkluzionin se çdo klasifikim sado i plotë e i gjerë shkencor nuk bën të mos jetë edhe i hapur, domethënë nuk bën të mos e pranojë edhe të mundshmen. Në këtë rast vlera estetike është më e madhe, ndonëse domethënia semantike e atributit mbetet disi e pakuptueshme, ezoterike, tekanjoze, ekstravagante. Kjo prirje, prej së cilës lind origjinaliteti, novatorizmi, prej së cilës mposhtet monotonia, përsëritja lodhëse, inflacioni, i tepëruar, është sidomos e rëndësishme, por edhe estetikisht më e begatë në poezinë e kultivuar. Dhe ndoshta, për z. Nezirin

kjo prirje mund të ishte, pas botimit të monografisë *Poetika e krahasimit*, një temë interesante duke vënë përballë krahasimin në poezinë e kultivuar me krahasimin në folklor. Kjo do të ishte si udhërrëfyese e shmangies së një imitimi të thjeshtë folklorizant, që ende vihet re aty-këtu në poezinë e kultivuar, e cila anon nga estetika e folklorit dhe nuk i lë të hapura portat për modele të tjera tash inekzistente, por të mundshme si gjatë zhvillimit të ardhshëm të poezisë sonë intuitive folklorike, ashtu edhe të poezisë së kultivuar novatore.

Një vlerë tjetër e padyshimtë e monografisë së z. Nezirit është edhe bibliografia e pasur për problemet e stilistikës së folklorit, që ndihmon në trajtimin e mëtejshëm të temës mbi stilistikën e prozodinë e lirikës në përgjithësi të folklorit e të poezisë së kultivuar. Botimi i kësaj monografie është shumë i dobishëm dhe i pasuron studimet shkencore të folklorit tonë.

## PAPET ME ORIGJINE ILIRE-ARBERORE

- **Shën Eleuteri** papë (prej Nikopolit të Epirit, Prevezë, në jug të Çamërisë) martir; mban fronin papnor në vitet 171-185. Festa e tij është me 26 maj. Renditet i katërbëdhjeti në listën e papëve. Ishte i biri i Abondit të Nikopolit. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani*, Roma 1949, vol. XXVI, p. 249; vol. XIII, p. 779; Zhan Klod Faveirial, *Historia e Shqipërisë*, Plejad 2004, f. 80].
- **Shën Urbani I** papë (prej Ilirie) martir, mban fronin papnor në vitet 222-230. Festa e tij është më 25 maj. Renditet i tetëmbëdhjeti në listën e papëve. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani*, Roma 1949, vol. XXVI, p. 249; vol. XXXIV, p. 771; Fan Stilian Noli, *O Zot, shpëtoje Shqipërinë*, në Saint George Cathedral, Boston (Usa), 1971].
- **Shën Kai** papë (prej Salone, Dalmaci) martir, mban fronin papnor në vitet 283-296. Festa e tij është më 22 prill. Renditet i njëzetënënti në listën e papëve. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da G. Treccani*, Roma 1949, vol. XXVI, p. 249; Zhan Klod Faveirial, *Historia e Shqipërisë*, Plejad 2004, f. 90].
- **Papa Gjoni IV Dalmati** (prej Ilirie), mban fronin papnor në vitet 640-642. Renditet i shtatëdhjetekatërti në listën e papëve. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da G. Treccani*, Roma 1949, vol. XVII, p. 252; vol. XXVI, p. 250].
- **Papa Pali IV (Karafa)** mban fronin papnor në vitet 1555-1559. Renditet i dyqindnjëzetepesti në listën e papëve. Gjatë kohës së tij, më 1555 botohet në shqip *Meshari* i Gjon Buzukut. Sot ndeshim një fshat arbëresh të Kalabrisë (në Katanaxaro), që mban emrin Karafa. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da G. Treccani*, Roma 1949, vol. II, p. 92; vol. VIII, pp. 927, 930; vol. XXVI, pp. 236, 250; *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Tiranë 1985, f. 136].
- **Papa Sisti V (Peretti)**, mban fronin papnor në vitet 1585-1590. Renditet i dyqintënjëzetënënti në listën e papëve. Familja Pereti emigroi në Itali nga Krusheva (Gryka e Kotorrit). [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da G. Treccani*, Roma 1949, vol. XXVI, p. 251; vol. XXXI, pp. 923-924; Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë 1991, f. 508].
- **Papa Klementi XI (Albani)**, mban fronin papnor në vitet 1700-1721. Renditet i dyqindëdyzetepesti në listën e papëve. Me urdhërin e tij u mbajt Koncili i Arbërit më 10 korrik 1703 në Merkinje të Lezhes, ku përveç të tjerash u vendos hapja e shkollave shqipe dhe botimi i teksteve në gjuhën shqipe. Aktet e këtij koncili u botuan në shqip më 1706. Familja Albani emigroi nga Arbëria në Urbino (Itali), më 1464. Mbiemri i tyre Laçi ndërroi në Albani. [Bibl. *Enciclopedia italiana fondata da G. Treccani*, Roma 1949, vol. II, p. 95; vol. X, p. 572; vol. XXVI, p. 251; *Fjalori enciklopedik shqiptar*, Tiranë 1985, f. 585].

Gjin Andrea Varfi